

**Bashkia:** TIRANË

**Kryetar:** ERION VELIAJ

**Fusha:** INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

**Premtime:**

1. Do të kryhet normalizimi i trafikut dhe përcaktimi i zonave me trafik të kufizuar me qëllim reduktimin e ndotjes
2. Do të kryhet nxitje e përdorimit të transportit publik përmes përmirësimit të standardeve të shërbimit
3. Do të kryhet promovim i përdorimit të mjeteve alternative të transportit si biçikletat duke shtuar korsitë e dedikuara, hapësirat pedonale dhe duke kontrolluar rreptësisht respektimin e tyre në territorin e bashkisë
4. Do të kryhet zbatimi me rreptësi i orareve kufizuese të qarkullimit brenda unazës për mjetet e tonazhit të rëndë
5. Do të kryhet kompletimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë
6. Do të kryhet plotësim i rrjetit rrugor me semaforë në territorin e bashkisë
7. Do të kryhet pajisja me ndriçim e të gjitha rrugëve të Tiranës duke përdorur teknologji të reja dhe efikase në përputhje me standardet europiane
8. Do të kryhet vendosja e kamerave të sigurisë për të monitoruar situatën e rendit në territorin e bashkisë
9. Do të kryhet rikthim në krye të detyrës të Policisë Bashkiake
10. Do të kryhet ndërtimi i një strehe në përputhje me standardet europiane për kafshët e rrugës në territorin e bashkisë
11. Do të kryhet rehabilitimi i të gjitha rrugëve të degraduara
12. Do të ndërhyet për vënien në funksion të plotë të sistemit të kanalizimeve në territorin e bashkisë për të shmangur situatat e përmbytjeve
13. Do të kryhet pajisje me puseta i të gjitha rrugëve dhe trotuareve
14. Do të kryhet rikthim në shërbim të qytetarëve i çdo metri katror hapësirë publike të zënë në mënyrë të paligjshme
15. Do të ndërhyet në infrastrukturën e kryqëzimeve rrugore për të rritur sigurinë e lëvizjes
16. Do të pajisen të gjitha rrugët në territorin e bashkisë me sinjalistikë
17. Do të kryhet krijimi i hapësirave për transportin publik dhe me biçikleta si pjesë e strategjisë së transportit dhe lëvizjes
18. Do të kryhet vlerësim i rrjetit rrugor ekzistues dhe investime për integrimin e zonave periurbane dhe rurale në territorin e Bashkisë së Tiranës
19. Do të zbatohet programi për kompletimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor që lidh zonat urbane me zonat rurale të Bashkisë së Tiranës
20. Do të përmirësohen procedurat e shërbimit duke frymëzuar një partneritet të ri e të shëndetshëm të privatesit me publiken
21. Do të kryhet rigjenerim i flotës së autobusëve duke nxitur përmes stimujve përdorimin e autobusëve me konsum efikas të karburantit, autobusëve hibridë dhe elektrikë

22. Do të kryhet rikonceptim i rrjetit të transportit publik duke konsoliduar e ndërlidhur 10 linjat ekzistuese urbane dhe 9 linjat komunale me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit për të gjithë banorët e Tiranës së re në të gjithë shtrirjen prej 100 kilometrash të rrjetit aktual të transportit publik
23. Do të rikthehen korsitë e dedikuara për transportin publik të shkatërruara gjatë katër viteve të fundit dhe do të koordinohet lëvizja e autobusëve me sinjalistikën e semaforëve duke i dhënë prioritet shpejtësisë së transportit publik
24. Do të ndërtohen tre stacione kryesore terminale në perëndim, verilindje dhe juglindje të Tiranës të cilët do të ndërlidhin të gjitha mënyrat e transportit në Tiranë dhe do të lejojnë ndërrimin e mjetit të transportit për udhëtarët
25. Do të bëhet e detyrueshme nisja dhe mbërritja e autobusëve interurbanë vetëm nga stacionet terminale
26. Do të rritet përdorimi i transportit publik dhe reduktohet përdorimi i mjeteve individuale
27. Do të përshpejtohen punimet për finalizimin e menjëhershëm të Unazës së Madhe për t'i dhënë frymëmarrje trafikut ndërqytetës
28. Do të hartohet masterplani i Tiranës për sa i përket lëvizjes pedonale, asaj me biçikleta
29. Do të pilotohet ideja e mesditave pa makina ku ndalohet lëvizja e makinave në rrugë të caktuara midis orës 11:30 dhe 13:00
30. Do të kryhet zhvillim i mëtejshëm i qendrës së menaxhimit të trafikut me qëllim për të rritur analizimin e trafikut, monitorimin dhe koordinimin në mënyrë dinamike të gjithë semaforëve të Tiranës dhe devijimin e trafikut drejt akseve me më pak ngarkesë
31. Do të krijohet një sistem i qartë dhe i thjeshtë i ndalimit të qarkullimit për automjetet që kryejnë transport mallrash, furnizim apo ndërtim në orë të caktuara dhe rrugë të caktuara të kryeqytetit
32. Do të krijohen zona me trafik të kufizuar në të cilat do të ndalohet qarkullimi i automjeteve gjatë orareve të pikut por pa penguar banorët e zonës dhe automjetet e urgjencës
33. Do të kryhet kontroll i rreptë për t'i dhënë fund fenomenit të uzurpimit të vendeve të parkimit në Tiranë
34. Do të investohet për ndërtim parkingjesh nëntokësore në partneritete publike private në territorin e bashkisë
35. Do të zbatohet skemë e re pagese për vendparkimet publike me pagesë ku fitimet e gjeneruara investohen për shërbimet publike
36. Do të zbatohet modeli "park&ride" ku banorët që udhëtojnë nga rrethinat e Tiranës do të kenë mundësinë të parkojnë pranë tre stacioneve terminale të Tiranës për të përdorur më pas transportin publik për të lëvizur brenda qytetit
37. Do të integrohen hapësirat e parkimit me monitorimin e lëvizjes në qytet duke lexuar specifikisht trafikun e krijuar nga sorollatja për gjetjen e një vendparkimi dhe duke eliminuar menjëherë këtë trafik nëpërmjet optimizimit të vendparkimeve në nivel lagjeje
38. Do të zbatohen praktikat më moderne për sa i përket teknologjisë së menaxhimit të parkimit duke ndërruar faurinot me sisteme efikase, të ndërlidhura dhe fleksibël të monitorimit dhe pagesës elektronike të vendparkimeve me pagesë
39. Do të ndërtohet Bulevardi i Ri i Tiranës

40. Do të përfundohet Unaza e Madhe e Tiranës
41. Do të ndërtohet rruga e Arbërit që lidh Tiranën me krahinat verilindore të Shqipërisë
42. Do të hartohet masterplani i lëvizjes pedonale dhe me biçikleta
43. Do të rikonstruktohen liqenet e Tiranës
44. Do të themelohet Fondi i Komunitetit si një mekanizëm për të bashkëfinancuar përmirësimin e lagjeve
45. Brenda mandatit të parë të gjitha pallatet do të kenë administrator që lincensohen nga Bashkia
46. Për pallatet e reja, bashkia do të inspektojë punimet
47. Nuk do të ketë më lejë të reja ndërtimi pa u shitur apartamentet që janë pa shitur aktualisht
48. Do të hipotekohen të gjitha pallatet që nuk janë bërë deri tani
49. Do të integrohet Parku i Liqenit me Parkun Zoologjik, Kopshtin Botanik dhe Parkun Olimpik
50. Do të ndërtohet Parku Olimpik
51. Do të zgjerohet sipërfaqja aktuale dhe do të shndërrohet kopshti zoologjik në një park zoologjik të standarteve më të larta
52. Do të investohet në projektin e Pazarit të Ri në bashkëpunim me Qeverinë dhe Fondin Amerikan të Zhvillimit
53. Nuk do të ketë leje për ndërtim në Qendrën Don Bosko
54. Nuk do të ketë më leje ndërtimi te Diga e Liqenit
55. Do të ndërtohet një urë e re në Shkozë e cila nuk do të përmytet
56. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, do të ndërtohet një qendër shëndetësore në Yzberisht
57. Do të ndërhyet për të rregulluar infrastrukturën rrugore në të gjithë Farkën
58. Do të shtrohen 3.5 km rrugë për t'u lidhur me Rrugën e Arbrit
59. Do të sigurohet një linjë transporti për Bërzhitën
60. Do të përfundojë ujësjellësi në Ibën e sipërme
61. Do të kryhet sjellja e ujit në disa zona të Baldushkut
62. Do të ndërtohet ura Koçaj-Vesqi
63. Do të investohet në një projekt pilot që do të kthejë Liqenin e Kasharit në një park të madh çlodhës
64. Do të kryhet integrim rrugor i fshatrave të Pezës me Tiranën
65. Do të kryhet ndërtimi i rrugës Pezë – Gjysyl Konjë (4km) dhe i rrugës së Varoshit (2 km)
66. Do të kryhet ndërlidhja me transportin publik me Tiranën

**Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT**

**Premtime:**

1. Do të kryhet garantimi i sigurisë së fëmijëve në çerdhe, kopshte dhe shkolla përmes kontrollit të rreptë e të vazhdueshëm të trafikut dhe rendit në zonat përreth institucioneve arsimore dhe të edukimit në territorin e bashkisë

2. Do të vendosen sisteme ngrohjeje në të gjitha çerdhet, kopshtet dhe shkollat në territorin e bashkisë brenda vitit të parë të mandatit
3. Do të vendoset sinjalistikë rrugore dhe elementë sigurie në çdo institucion arsimor dhe të kujdesit social në territorin e bashkisë brenda 100 ditëve të para të mandatit
4. Do të kryhet rikonstruksion dhe rehabilitim i terreneve sportive dhe rekreative në çdo çerdhe, kopësht dhe shkollë në territorin e bashkisë
5. Do të kryhet pajisje e çerdheve dhe kopshteve në territorin e bashkisë me materiale didaktike dhe ndihmëse për zhvillimin e fëmijëve, brenda vitit të parë të mandatit
6. Do të funksionojnë 10 Shkolla si Qendra Komunitare brenda vitit të parë të mandatit dhe 50 të tilla brenda mandatit
7. Do të ndërtohen 5 çerdhe të reja në territorin e bashkisë
8. Do të ndërtohen 8 kopshte të integruara me çerdhe në territorin e bashkisë
9. Do të ndërtohen 10 shkolla të reja në territorin e bashkisë
10. Do të kryhet garantim i pjesëmarrjes së artistëve dhe qytetarëve në procesin këshillimor për zhvillimin e agjendës kulturore të qytetit
11. Do të krijohet një kalendar mujor/vjetor i aktiviteteve artistike, kulturore dhe festive
12. Do të mbështeten skenat kulturore për artistët në hapësira publike si dhe nxitja e "streetart" (këngëtarë, instrumentistë, artistë të artit pamor, artistë performues etj)
13. Do të kryhet ngritja e një teatri kukullash lëvizës për zonat rurale
14. Do të kryhet një hartë e plotë e zonave me vlera historike, sociale, kulturore dhe sportive
15. Do të kryhet riaktivizim i bibliotekave të lagjeve dhe ngritja e bibliotekave funksionale për zonat rurale
16. Do të kryhet inkurajim i ndërtuesve për të investuar 1% të totalit të kostos së ndërtimit për hapësira të gjelbërta dhe art publik, kryesisht në zonat përreth ndërtimit të kryer
17. Do të nxitin dhe inkurajohen artet alternative si dhe do të përfshihet Tirana në agjenda kulturore të ndryshme ndërkombëtare (bienale, opera, festivale etj.)
18. Do të themelohet Këshilli i të Rinjëve pranë Bashkisë Tiranë
19. Do të trefishohet buxheti për rininë
20. Do të vihet në funksion Karta e të Rinjëve dhe Studentëve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
21. Do të zbatohet projekti Shkolla si Qendër Komunitare në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
22. Do të mbështeten sipërmarrjet rinore
23. Do të garantohet siguria në shkolla në bashkëpunim me Policinë e Shtetit
24. Do të themelohet Inkubatori i Biznesit për të rinjtë e Tiranës
25. Do të organizohet kampionati i përvitshëm sportiv me gjimnazet e Tiranës
26. Do të rikthehet "Rinfest"
27. Do të ndërtohen 6 qendra të reja rinore
28. Do të kryhet rehabilitimi i terreneve dhe sallave sportive në të gjitha shkollat e Tiranës
29. Do të kryhen hapësira sportive në lagjet e Tiranës si dhe në çdo njësi administrative rurale të cilat do të shërbejnë edhe si hapësira të integritit të komunitetit
30. Do të krijohen ekipet e shkollave në sporte të ndryshme si dhe organizim i kampionateve midis tyre

31. Do të ketë partneritet të ngushtë me sportdashësit dhe ekipin e Tiranës
32. Do të mbështeten klubet dhe shoqatat sportive që ushtrojnë aktivitetet në territorin e bashkisë bazuar mbi kritere të qarta, transparente dhe objective
33. Do të dyfishohet fondi për sportin në buxhetin e bashkisë në vitin e parë të mandatit dhe trefishim i tij deri në fund të mandatit
34. Do të dyfishohen hapësirat sportive për çdo 100000 banorë brenda vitit të parë të mandatit duke aktivizuar ambientet e shkollave si qendra komunitare dhe duke i vënë ato plotësisht në shërbim të sportit
35. Do të krijohen 40 ambiente sportive për çdo 100000 banorë brenda mandatit
36. Do të krijohen 90 ambiente të reja sportive në hapësirat e lira brenda blloqeve të banimit
37. Do të rehabilitohen të gjitha ambientet sportive në pronësi të Bashkisë
38. Do të garantohen mundësi të barabarta për të gjitha moshat për t'u ushtruar në infrastrukturën publike ekzistuese dhe atë që do ndërtohet
39. Do të kryhet kalendar me aktivitete publike sportive masive, në bashkëpunim me Universitetin e Sportit
40. Do të organizohen aktivitete Post-kurrikulare në shkolla
41. Do të organizohen aktivitete Ekstra-kurrikulare në shkolla
42. Do të organizohen aktivitete komunitare në shkolla
43. Do të bashkëpunohet me qeverinë që stadiumi kombëtar të jetë jashtë Tiranës
44. Nuk do të firmoset dhe nuk do të rinovohet asnjë kontratë që i heq copa (llokma) aseteve të klubit Tirana për t'ia dhënë të tretëve
45. Do të ndërtohet Kampusi i Universitetit të Tiranës
46. Do të ndërtohet Kampusi i Universitetit Politeknik të Tiranës
47. Do të ndërtohet Qendra e Studentëve
48. Do të rikonstruktohet shkolla "Lasgush Poradeci" dhe kopshtet 21 dhe 34
49. Do të ndërtohet një kopësht dhe një shkollë 9-vjeçare e re në zonën e Unazës së Re, pranë KMY-së në Yzberisht
50. Do të kryhet rikonstruktimi i fushës së sportit në qendër të Kombinatit, që është 18 mijë metra katrorë

**Fusha: MJEDIS/TURIZËM**

**Premtime:**

1. Do të kryhet garantim i pastërtisë së rrugëve dhe hapësirave publike në territorin e bashkisë përmes investimit në mjete dhe pajisje të standardeve më të larta teknike
2. Do të kryhet mbledhje e mbeturinave në oraret me më pak lëvizje në territorin e bashkisë
3. Do të kryhet vendosja e detyrueshme e sistemeve të filtrimit për bizneset që krijojnë ndotje në territorin e bashkisë
4. Do të kryhet ndërtimi i një impianti për përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve duke ndaluar rreptësisht djegien e tyre në territorin e bashkisë
5. Do të kryhet rehabilitimi dhe gjelbërimi i 135810 m<sup>2</sup> hapësira publike të çliruara nga ndërtimet informale gjatë 2 viteve të fundit në Tiranë

6. Do të kryhet rigjenerim dhe transformim i ish zonave industriale të Tiranës në hapësira të gjelbërta dhe në shërbim të komunitetit
7. Do të kryhet aplikim në projektin " Fasadat e Gjelbra" me qëllim krijimin e hapësirave të gjelbërta vertikale
8. Do të kryhet identifikimi dhe shndërrimi i hapësirave potenciale brenda blloqeve të banimit në hapësira të gjelbërta në partneritet me komunitetin dhe bizneset e zones
9. Do të kryhet pastrimi nga mbetjet e lumenjëve në territorin e Bashkisë së Tiranës përgjatë gjithë rrjedhjes së tyre
10. Do të kryhet ndërtimi i një impianti modern i përpunimit të ujërave të zeza në mënyrë që ato të mos derdhen më në Lumin e Lanës apo Lumin e Tiranës
11. Do të hartohet një guidë e plotë turistike shqip dhe anglisht për të gjitha atraksionet turistike dhe kulturore që ofron Tirana
12. Do të ndërtohet një faqe interneti për promovimin e të gjitha llojeve të turizmit në Tiranë
13. Do të kryhet negociim për hapjen në Tirane të një hoteli tjetër, pjesë e rrjetit ndërkombëtar të hotelerisë
14. Do të krijohen guida audio për turistët e huaj për zona specifike të Tiranës
15. Do të krijohen guidat dhe hartat e lëvizjes (tracking routes) për ekskursionet ditore ose gjysmë ditore
16. Do të vendosen linja transporti të dedikuara drejt pikave turistike më strategjike
17. Do të ofrohen incentiva për fermerët dhe bizneset agro-bujqësore për të zhvilluar agroturizmin
18. Do të krijohen zona pedonale dedikuar tregjeve të përkohshme dhe hapësirave rekreacionale
19. Do të kryhet konsolidim dhe zgjerim i traditës së krijuar me Natën e Bardhë me festivale të tjera dhe ngritja e këtyre eventeve në nivelin e një eventi kulturor ndërkombëtar
20. Do të kryhet orientim i industrisë turistike drejt turizmit të biznesit duke synuar tregun MICE (Takime, Nxitje, Konferenca, Evente)
21. Të gjitha të ardhurat që do të mbliidhen nga parkingu, do të jenë të destinuara për gjelbërimin e qytetit (2 milion dollar në vit)
22. Do të synohet kthimi i Krrabës në një zonë atraksioni turistik të qytetit, të rikthehen banorët e vjetër të saj për të ofruar shërbime
23. Do të kryhet pastrimi dhe mirëmbajtja e disa rezervuarëve në Baldushk

## **Fusha: BUJQËSI**

### **Premtime:**

1. Do të kryhet tregëtim i produkteve bujqësore vetëm në tregje që respektojnë standardet më të larta higjeno-sanitare
2. Do të kryhet zbatim me rreptësi i ligjit për ekspozimin e origjinës, llojit dhe çmimit për çdo produkt të tregtuar
3. Do të kryhet garantimi i çertifikimit të produktit dhe kontrollit të cilësisë në përputhje me standardet europiane

4. Do të rikthehet në krye të detyrës Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit
5. Do të kryhet rikonceptim i shpërndarjes gjeografike dhe organizimit të tregjeve
6. Do të kryhet përcaktim i zonave për tregje të përhershme dhe i zonave për tregje të përkohshme dhe ditore
7. Do të zbatohet politika "km 0" me synim përcaktimin e pozicioneve specifike të tregjeve pranë zonave të prodhimit
8. Do të zbatohet programi i ndërhyrjes për vendosejn në punë të sistemit të vaditjes dhe kullimit në territorin e Bashkisë së Tiranës
9. Do të kryhet koordinim dhe ndërmjetësim në ekonominë rurale për të reduktuar fragmentarizimin e tokës bujqësore dhe rritjen e produktivitetit
10. Do të ngrihet Qendra e Agronomisë dhe Veterinarisë pranë Bashkisë së Tiranës për të ndihmuar e orientuar fermerët
11. Do të ngrihet Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes së Zonave Rurale për të ofruar asistencë teknike dhe grante për fermerët
12. Do të ndërtohen pika grumbullimi të prodhimeve bujqësore e blegtorale përmes skemave të Partneriteteve Publike Private
13. Do të ndihmohen me grante të gjithë ata që kanë një projekt mbi kulturat bujqësore
14. Tirana do të ketë minimalisht 4 tregje në të gjitha pikat hyrëse dhe kjo do të sjellë treg të sigurtë të prodhimeve tuaja
15. Do të zbatohet politika të KM 0, në mënyrë që njerëzit nga Tirana të blejnë produktet në Krrabë

**Fusha: TRANSPARENCA**

**Premtime:**

**Fusha: SHËRBIMET SOCIALE**

**Premtime:**

1. Do të hapen 3 mensa sociale në territorin e bashkisë për të ofruar ushqim falas për shtresat në nevojë, në partneritete publike private
2. Do të hapen 5 qendra ditore për të moshuarit në territorin e bashkisë
3. Do të zbatohet programi Riintegrit Social përmes të cilit do t'u ofrohet punë në shërbim të komunitetit qytetarëve që përfitojnë Ndihmë Ekonomike
4. Do të kryhet garantim i aksesit në institucionet në Tiranë për Personat me Aftësi të Kufizuar
5. Do të zbatohet program i posaçëm për Mbrojtjen dhe Kujdesin për Fëmijët në Situatë Rruge
6. Do të kryhet, brenda 100 ditëve të para të mandatit, shpërndarja e të gjitha banesave sociale (385 banesa) dhe hartim i një politike të mirëfilltë për strehimin social
7. Do të ndërtohet një park që do të jetë simbol i harmonisë fetare që karakterizon vendin, Parku i Besimit

8. Do të hapen shtëpi veteranësh, ku të shërbehet me kosto shumë të ulët shtypi i ditës dhe kafeja e mëngjesit
9. Në 24 njësi do të vendosen 24 partneritete me komunitetin e veteranëve
10. Do të kryhet një inventar i objekteve personale të veteranëve që kanë nevojë për restaurim

**Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM**

**Preftime:**

1. Do të kryhet punësim me kohë të pjesshme në programin e Shkollave si Qendër Komunitare për 100 individë brenda vitit të parë të mandatit dhe 500 brenda mandatit
2. Do të themelohet Këshilli Ekonomik i Tiranës si një forum bashkëpunimi mes bizneseve dhe pushtetit lokal
3. Do të krijohet fond lokal për nxitjen e punësimit duke bashkëpunuar dhe koordinuar me Shërbimin Kombëtar të Punësimit
4. Do të ngrihet Zyra e Punës së Tiranës
5. Do të themelohet Agjencia e Administrimit Ekonomik e cila do të ofrojë konsulencë falas për orientimin e aktivitetit ekonomik lokal dhe do të ndërmjetësojë me bizneset lokale, me autoritetet qendrore dhe aktorë të tjerë privatë si pjesë e sistemit financiar
6. Do të vendoset një kuotë 30% për shpërndarjen vjetore të kontratave/prokurimeve në sektorin e biznesit të vogël e të mesëm për të nxitur zhvillime pozitive në këtë sektor duke orientuar drejt tij shumicën e shpenzimeve /blerjeve që bën Bashkia
7. Do të ofrohet ndërmjetësim falas tek institucionet financiare të mikrokredisë për bizneset lokale
8. Do të organizohet "Konkurs vjetor me ide novatore" dhe do të mbështeten e financohen idetë më të mira për bizneset e reja
9. Do të thjeshtohen procedurat e taksimit dhe aplikimit për leje e licenca
10. Do të ngrihet Qendra e Artizanëve të Tiranës për të ofruar trajtim të veçantë dhe subvencione për biznesin e vogël artizan
11. Do të hartohet një paketë e plotë për të mbështetur bizneset që eksportojnë
12. Do të funksionojë taksa progresive
13. Do të vendoset një fond i bashkisë për nxitjen e punësimit të të rinjve
14. Do mundësohet që 1000-1200 të rinj të bëjnë praktikën në bashki
15. Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë do t'i jepet biznesit që është i fokusuar në produktet "MADE in TIRANA", kapanone me qira 1 euro m<sup>2</sup>